

K.B
- Finance
Dt 07.01.2026



BASHKIA BULQIZE
SEKTORIA
NR. 12 DATE 07.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBER

Nr.1207/I prot.

Peshkopi, më 05.01.2026

Lënda: Për vendimin nr.101, datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Bulqizë.

KËSHILLIT BASHKIAK BULQIZË

BASHKISË BULQIZË

BULQIZË

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Bulqizë nr.101, datë 24.12.2025 "*Për miratimin e programit përgatitor buxhetor aftamesëm 2026-2028*", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi, në zbatim të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë, që paraqesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHIRBU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBER

Nr.1207/1 prot.

Peshkopi, më 05.01.2026

Lënda: Për vendimin nr.101, datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Bulqizë.

KËSHILLIT BASHKIAK BULQIZË

BASHKISË BULQIZË

BULQIZË

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit Bashkiak Bulqizë nr.101, datë 24.12.2025 "*Për miratimin e programit përgatitor buxhetor aftamesëm 2026-2028*", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi, në zbatim të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë, që paraqesin për miratim projekt-akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





PREFEKTURA DIBËR

Ardhur
Nr. 1307 dt 31.12.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 318 Prot.

Bulqizë, më 29.12.2025

Lënda: Dërgohet V.K.B për konfirmim

Drejtuar : Prefekturës së Qarkut Dibër, Peshkopi.

Bashkangjitur ju dërgojmë për konfirmim vendimin Nr. 101 datë 24/12/2025 të Keshillit Bashkiak Bulqizë që bën fjalë për:

PER MIRATIMIN E PROGRAMIT PERGATITOR BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028

Bashkangjitur: Vendimi i Këshillit Bashkiak, Projekt Vendim, PBA

Numri i fleteve 3 + 183 f.g.

PËR KËSHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI

KLODIAN REÇI

KRYETARI

ARBEN ÇUPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 101 Datë 24/12 2025

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËRGATITOR BUXHETOR AFATMESËM
2026-2028**

Bazuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njesive të vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit vjetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.8 datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028"

Këshilli Bashkiak mbledhur me datë 24.12.2025 me 13 vota pro, 3 kunder, asnjë abstenim.

VENDOSI:

1.Miratimin e programit përgatitor buxhetor afatmesëm 2026 -2028, pjesë përbërëse e Sistemit të Menaxhimit Buxhetor Vendor (SMBV).

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Prefekti.

PËR KËSHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI

KLODIAN REÇI

KRYETARI

ARBEN ÇUPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BULQIZË

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ÇSHTJEVE EKONOMIKE DHE FINANCIARE

PROJEKT - VENDIM

Nr. 13 date 17 / 12 / 2025

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT PËRGATITORE BUXHETOR AFATMESËM
2026-2028.**

Bazuar në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njesive të vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit vjetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.8 datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 - 2028" i propozojmë Këshillit të Bashkisë të gjykojë dhe të

VENDOSË:

1.Miratimin e programit përgatitor buxhetor afatmesëm 2026 -2028, pjesë përbërëse e Sistemit të Menaxhimit Buxhetor Vendor (SMBV).

Jurist

Zhuljeta Deda

Drejtori i AGEF

Rustem BICI

KRYETAR

Festime MJESHTRI





PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028

Dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

LOGO.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1. HYRJE	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE)	10
2.1 SITUATA E NJËRISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	10
2.2 ÇESHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË BULQIZË	12
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË BULQIZË (1-2 FAQE)	13
3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË	13
3.2 SHIAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJAE PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRITUESIT	13
4. BUXHETI AFATMESEM I BASHKISË BULQIZË 2026-2028	33
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË BULQIZË NË VITET 2026-2028	34
4.1.1 TË ardhurat e parashikuara të Bashkisë BULQIZË për vitet 2026-2028	34
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë BULQIZË për periudhën 2026-2028	26
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR	41
5. BUXHETI AFATMESEM PËR PROGRAMET BUXHETORE	42
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	43
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	44
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit	45
5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin	46
6. BUXHETI VJETOR	47
6.1. DOKUMENTACIONI BAZË	47
6.2. DOKUMENTACIONI SHQËRUES	47

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Bulqizë	33
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	34
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike	37
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	39
Tabela 5. Shpenzimet e NivQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG)	40
Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	42
Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit	43
Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit	44
Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit	45
Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin	46

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVY	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavejcare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavejcare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohej një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar

kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisve vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësis vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmblodhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektive të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arrijtjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektive të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektive të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkte SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2026-2028 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", udhëzimit nr.8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028", Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr.91 datë 26.12.2024 ku është miratuar "Kalendarin i përgatitjes së PBA 2026-2028"

Në zbatim të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë, në rolin e nëpunësit autorizues, me Urdhërin 392 datë 01.09.2025 "Për ngritjen e grupit për menaxhim strategjik" ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik i cili është përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të planifikimit për Bashkinë Bulqizë. Urdhërin Nr. 215, datë 30.04.2025 "Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve" ka ngritur grupet e menaxhimit të programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, i ndryshuar me Urdhërin nr 395 datë 01.09.2025. Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 18, datë 30.04.2025 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026-2028" janë miratuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026-2028, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese. Gjithashtu me

Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 63, datë 22.07.2025 "Për miratimin e taveveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026-2028" janë miratuar tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2026 - 2028, sipas programeve dhe për çdo njësi shpenzuese Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 19, datë 30.04.2025 "Për miratimin e parashikimit të të ardhurave të PBA 2026-2028"

Në zbatim të Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe të Udhëzimit Vjetor Nr.8 datë 28.02.2025, pasi u hartua projekt dokumenti i parë i PBA 2026-2028 ju dërgua për rekomandime dhe komente Ministrisë së Financave të cilët kthyen përgjigje me shkresën me Nr.Prot 9739 datë 18.06.2025 me lëndë: "Dërgohen mendimet mbi programin buxhetor afatmesëm 2026-2028". Referuar analizës së bërë nga Ministria e Financave ndër të tjera është cituar se në relacionin shoqërues është paraqitur një informacion i detajuar për procesin e PBA 2026-2028 lidhur me të ardhurat nga taksat dhe tarifat, faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në të ardhmen në rritjen e nivelit të të ardhurave si dhe për shpenzimet sipas funksioneve, kategorive ekonomike dhe sipas programeve buxhetore.

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme është hartuar bazuar në politikat fiskale ekzistuese, në të dhënat historike të arkëtimit dhe trendit vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit për këtë taksë, vlerësimet mbi zhvillimet e mundshme ekonomike. Përsa i përket shpenzimeve rekomandohet që në periudhë afatmesme Bashkia Bulqizë të synojë që peshën më të madhe të shpenzimeve buxhetore ta zënë shpenzimet për investime duke ulur nivelin e shpenzimeve operative dhe shpenzimeve të personelit.

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfer tën e pakushtëzuar të përgjilshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor.

Dokumentit i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përfshikon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Bulqizë shtrihet në rajonin verilindor të Shqipërisë, e cila në veri kufizohet me bashkinë Dibër, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jugperëndim me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Librazhd dhe në perëndim me bashkinë Klos. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës. Gjatësia e vijës kufitare është 120 km. Nga këto gjatësia e vijës kufitare me bashkinë e Dibërs është 25 km, me bashkinë e Librazhdit 29 km, me Republikën e Maqedonisë 30 km, me bashkinë e Klosit 23 km dhe me bashkinë e Tiranës 13 km. Bashkia e Bulqizës ka një sipërfaqe 678.51 km². Gjithë territori i bashkisë shtrihet nga 300 m, deri në 2000 m lartësi mbi nivelin e detit. Bashkia e Bulqizës ka në përbërje 7 njësi administrative të cilat janë: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zërqa, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht. Oferta gjeografiko-natyrore është një nga elementët e rëndësishëm të zhvillimit turistik. Potenciali natyror përbën bazën e potencialit turistik primar pasi ai ka të bëjë si dhe në gjatë mënyrë mjedisi gjeografik natyror ndikon në zhvillimin e turizmit në bashkinë Bashkisë.



Qyteti i Bulqizës shërben në një farë mënyre si një portë hyrëse e Bashkisë nga ku kalon rruga e Arbërit dhe Rruga që lidhë Bashkinë në vashdim me Librazhdin e më tej me bashkitë e tjera të rajonit. Kjo portë e bashkisë, pra vetë qyteti i Bulqizës bën të mundur që në vazhdim të tij të njihemi me qendrat e banuara si: Fushë-Bulqiza, Zërqa (si pjesë e 100 fshatrave) Shupenza etj duke dalë nga bashkia për t'u lidhur me pjesën veriore të Rajonit. Nderkohe nga Qyteti i Bulqizës vazhdohet edhe rruga drejt rrugës së Librazhdit me qendrat e tjera të banuara si: Ostren, Tërnovë, Okshtun për të vazhduar me pjesën jugore të Rajonit. Njësia Administrative Martanesh shërben si një zonë më vete për bashkinë, për shkak të territorit të saj malor që mbizotëron në të. Këtu spikatet një potencial i pasur i florës dhe faunës, monumenteve natyrore dhe kulturore. Një element tjetër i rëndësishëm në zhvillimin e qendrave të banuara shërben Trebishti, sot pikë kufitare doganore, ekzistuese e cila ka nevojë të dal dhe më tepër si rritje potenciale të bashkëpunimit ndërkufitar midis Bulqizës (si portë rajonale dhe Maqedonisë së Veriut).

RELIEVI Bashkia e Bulqizës karakterizohet nga një reliev kodrinor-malor. Si rezultat i larmisë litologostruktorore si dhe faktoreve të morfodinamikës së jashtme (klima dhe hidrografia), bashkia e Bulqizës ka një reliev të larmishëm ku malet janë të gërrshetura me luginat. Në nënjesitë e relievit të Bulqizës përmendim: mali e Homeshit, mali i Dhokës, mali i Kaptinës, lugina e Bulqizës, lugina e Planit të Bardhë, lugina e Valit etj. Në përgjithësi mbizotëron relievi i lartë mbi 1000 m. Përsa i përket llojeve të relievit, janë të pranishëm relievi strukturor-eroziv, relievi karstik, relievi eroziv-denudues si dhe relievi akullnajor.

KLIMA Në bashkinë e Bulqizës dallohet zona klimatike mesdhetare paramalor dhe mesdhetare malore e cila karakterizohet nga dimër i ftohtë me temperatura nën 0 gradë C dhe me reshje të pakta. Klima e kësaj luginë është mjaft e ftohtë, gjë e cila lidhet jo vetëm me lartësinë e madhe mbi nivelin e detit, por dhe me erën e fortë që fryn. Duke qenë e hapur nga lindja, nëpër të depërton murlani nga lugina e Drinit të Zi. Këtu erërat lindore kanalizohen dhe forcohen dhe vazhdojnë rrugën për në luginën e Matit, pasi Qafa e Buallit ka lartësi të vogël relative. Prandaj në luginën e Bulqizës dhe në Qatën e Buallit pothuajse vazhdimisht fryn erë. Kjo luginë përshkohet nga Zalli i Bulqizës që merr dege të shumta nga e majta dhe e djathta, dhe derdhet më pas në Drinin e Zi. Reshjet në këtë rreth janë nën mesataren e vendit.

HIDROGRAFLA Bulqiza paraqitet me një rrjet hidrografik mjaft të pasur. Lumi kryesor që rrjedh në territorin që përfshin kjo bashki është Drini i Zi. Lumi Drin përshkon 6.85 km në territorin e bashkisë Bulqizës. Ky lum buron nga liqeni i Ohrit, pas daljes nga ky liqen në qytetin e Strugës vazhdon rrugën nëpër një sërë grykash të ngushta të cilat mbarojnë në Urën e Spilesë. Arteri kryesor i Drinit, pasi kalon në kufijt shtetëror të vendit është Zalli i Bulqizës. Zalli i Bulqizës, i cili buron në liqenët e Balgjajt, merr me vete shumë përmirë të vegjël e perroska. Formohet nga bashkimi i ujërave të përroit të Okshtunit dhe përroit të Dushajt.

BIODIVERSITETI Bashkia e Bulqizës është mjaft e pasur me bime dhe kafshë. Shpërndarja e tyre kudo në male, kodër, luginë, fusha etj, është mjaft e larmishme në numër në lloje. Në qytet (Bulqizë e Krastë), bimësia brenda qytetit është e kultivuar, kryesisht bimi dekorative si: bredhi, pisha, bliri, akacia etj. Mbjellja e këtyre pemëve dekorative ka filluar të aplikohet edhe në qendrat e komunave. Bashkia Bulqizës dallohet për një mbulesë bimore mjaft të pasur në sasi dhe në lloje.

ZHVILLIMI I INDUSTRIËS Bulqiza është një nga vendet më të pasura me mineral kromi në Ballkan dhe shfrytëzohet që nga 18.02.1948. Minierat kryesore janë në Bulqizë, Krastë e Tërnova. Industria minerare është dega kryesore e ekonomisë në dy njësi administrative (Bulqizë dhe Martanesh) 119 subjekte në fushën minerare ushtrijnë aktivitetin në zonë nga të cilat 112 me leje shfrytëzimi, 4 me leje kërkim zbulimi dhe 3 me leje zbulimi. Sasia e përgjithshme e rezervave të mineralit të kromit në masivin Bulqizë -Bater sipas KNR (Klasifikimi ndërkombëtar i Rezervave, Strategjia e promovimit të mineraleve të Shqipërisë) rezulton të jetë 10 080 507 ton.

ZHVILLIMI I BUJQËSISË Bujqësia është e organizuar në ferma të vogla familjare, sipërfaqja e tokës së punueshme është e vogël, e copëzuar dhe terren i pjerrët. Rreth 34.5% e të punësuarve janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë. Sistemi i ujitjes është i amortizuar. Mungesa e baxhove infrastruktura e papërshtatshme, promovim i dobët mungesa e markës dhe emigrimi i krahut të punës shihet si shqetësues për disa fermerë. Skema e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes vlerësohet si e papërshtatshme. Tek fermerët mbisundon mentaliteti individual dhe mungojnë qasjet e punës në grup.

ZHVILLIMI I TURIZMIT. Turizmi është parë si një mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës nga të gjitha njësit administrative. Pavarësisht se të gjitha njësitë kishin në vizionin, synimet dhe projektet tyre, zhvillim e turizmit, ai mbetet në hapat e parë të zhvillimit të tij.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë.

Në hartimin e planit të investimeve u morën parasysh disa elementë të rëndësishëm si:

- nevojat dhe prioritetet e qytetarëve nga njëra anë dhe kapacitetet e mundësitë financiare të bashkisë për investime nga ana tjetër;
- mundësitë e ndërveprimit dhe partneritetit të bashkisë me komunitetin, donatorët, programet e ndryshme të zhvillimit (Fondi i Rajoneve, projektet e bashkëpunimit ndërkufitar etj.);
- perspektiva e qeverisjes vendore e saksionuar në dokumentat strategjikë kombëtarë.

Plani i investimeve mund të përditësohet çdo vit me miratimin e buxhetit. Ai mbart disa avantazhe në drejtim të perspektivës së bashkisë dhe të proceseve të planifikimit pasi:

- orienton vëmendjen tek prioritetet, nevojat dhe mundësitë financiare të bashkisë në investime;
- ndihmon bashkinë në rritjen e qendrueshmërisë financiare dhe mirë-menaxhimin e burimeve financiare;
- siguron transparencën në fondet për investime;
- përmirëson bashkëpunimin dhe komunikimin midis stafit të bashkisë dhe aktorëve të tjerë në territor;
- përmirëson infrastrukturën, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë mundëson edhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ka një angazhim të fortë të Bashkisë Bulqizë ndaj realizimit të planit të investimeve përmes një plani detyrash të mirëpërcaktuara nga kryetari i bashkisë. Disa nga këto detyra afatshkurtra (100 ditët e para) që do të lehtësojnë dhe krijojnë infrastrukturën e domosdoshme për realizimin e planit të investimeve janë:

- përmirësimi i kapaciteteve financiare të bashkisë nëpërmjet riorganizimit të strukturës administrative të taksë-tatimeve, përmirësimit të paketës financiare, si dhe të vjeljes së rentës minerare;
- ngritja e strukturës administrative për hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe rritja e kapaciteteve të saj;
- studimi i mundësisë së ngritjes të një agjencie për zhvillimin vendor apo të praktikave të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti (CLLD)¹, siç janë grupet lokale të veprimit;
- miratimi i rregulloreve dhe i instrumentave të pjesëmarrjes së komunitetit në planifikimin dhe zhvillimin vendor;
- riorganizimi i administratës së bashkisë dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të saj;
- krijimi i instrumentave të ndërveprimit dhe partneritetit me sipërmarrësit privat dhe shoqërinë civile;
- miratimi i rregulloreve të transparencës dhe të monitorimit financiar;
- hartimi i paketës së parë të projekteve zhvillimore dhe aplikimi në thirrjet e radhës nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, projektet e bashkëpunimit ndërkufitar me Kosovën dhe Malin e Zi në kuadër të programit IPA, programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim (IADSA) dhe donatorë të tjerë.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Objektivat strategjik për bashkinë Bulqizë janë konceptuar në përputhje me realitetin lokal të kësaj bashkie si dhe me synimin që të arrihet përmbushje e vizionit strategjikë. Duke u mbështetur në rezultatet e analizës së gjendjes ekzistuese si dhe nga konsultat me aktor vendas, janë konceptuar 6 objektivat strategjike.

1. Objektivi strategjik 1 është "Mbrotja e mjedisit", si një bashki që pjesën më të madhe të territorit e ka natyrën, mbrojtja e mjedisit është primare në aktivitetin bashkiak por edhe qytetar.
2. Objektivi strategjik 2 është "Përmirësimi i bashkëpunim ndërkuftar të bashkisë", ky objektivi është konceptuar në kuadër të strategjive kombëtare për turizmin dhe bashkëpunimin ndërbashkiak si dhe në kuadër të projekteve IPA të financuara nga BE.
3. Objektivi strategjik 3 është "Përmirësimi i shërbimeve publike" ky objektivi është konceptuar sidomos për përmirësimin e shërbimeve në zonat më periferike të bashkisë atje ku sot shumë prej shërbimeve publike mungojnë tërësisht.
4. Objektivi i strategjik 4 është "Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit dhe Promovimit kulturor dhe natyror", si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë, turizmit në bashkinë Bulqizë do të shtohen në fondin e tij dhe asetet kulturore dhe monumentale si pika atraktive duke i bërë pjesë të itinerareve turistike.
5. Objektivi strategjik 5 është "Përmirësimi dhe promovimi i bujqësisë dhe blegtorisë", një objektivi shumë aktual në kuadrin e rritjes së mundësisë së plotësisht të nevojave të tregut vendas por dhe tregëtimin e produkteve jashtë territorit të bashkisë apo shtetit shqiptar.
6. Objektivi strategjik 6 është "Organizimi i hapësirave urbane të bashkisë", me anë të këtij objektivi strategjikë vihet në fokus përshtatja e strukturave urbane të Bulqizës së Re dhe asaj të Vjetër dhe Krastës si Hapësira urbane në bashkinë e Bulqizës, qëllimi i këtij objektivi është drejtimi i zhvillimit urban konform parametrave kontemporanë të zhvillimit si dhe në përputhje me legjislacionin territorial sqqipëtar.

Përgjatë kësaj periudhe Bashkia e Bulqizë ka miratuar disa strategji apo plane veprimi sektoriale, si më poshtë:

- Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV);
- Plani Social i Bashkisë Bulqizë 2024-2027;
- Programi 5-Vjeçar i Strehimit në Bashkinë Bulqizë 2024-2029.
- Plani i menaxhimit të mbetjeve 2024-2030.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit

1: Përfshirje e aktivizim i potencialeve të shtresave vulnerabël në shoqëri nëpërmjet krijimit të shanseve të barabarta për punësim, arsimim e trajnim si edhe përfshirjes në strukturat e vendimmarrjes.

- Masa 1 Nxitja e punësimit të të rinjve dhe sidomos grave nëpërmjet politikave që synojnë diversifikimin e ekonomisë lokale dhe hapjen e vendeve të reja të punës.
- Masa 2 Nxitja e hapjes së institucioneve të arsimit profesional publik e privat dhe kurseve të kualifikimit.

- Masa 3 Monitorimi i zbatimit të kuotave gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe inkurajim i shtimit të numrit të grave në to.
- Masa 4 Nxitja e përmirësimit të pozitës së gruas dhe ndryshimit të mendësisë patriarkale nëpërmjet inkurajimit të shoqatave që promovojnë fuqizimin e gruas dhe rritjen e rolit të saj në shoqëri.

2: Shfrytëzim i plotë i potencialeve në bujqësi e blegtori nëpërmjet krijimit të infrastrukturës mbështetëse moderne dhe nxitjes së ekonomisë së shkallës.

- Masa 1 Rikonstruksioni i sistemeve ujitëse e kulluese.
- Masa 2 Ndërtimi i tregjeve dhe pikave moderne të magazinimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale.
- Masa 3 Ndërmarrja e nismave për eliminimin e copëzimit të fermave dhe krijimin e ekonomisë së shkallës.
- Masa 4 Stimulimi nga ana e pushtetit vendor i mekanizmave financiare për subvencionimin e inputeve dhe investimeve.

3: Zhvillimi i zinxhirit të vlerës së turizmit dhe shndërrimi i tij në burim punësimi dhe mirëqenie në Bashkinë Bulqizë.

- Masa 1 Mbrojtja dhe përmirësim i mjedisit dhe sidomos i masiveve pyjore, parqeve e zonave të mbrojtura.
- Masa 2 Përmirësimi i infrastrukturës turistike informuese.
- Masa 3 Përmirësimi i marketingut territorial për Bashkinë Bulqizë.
- Masa 4 Rritja e vizibilitetit të resurseve turistike.
- Masa 5 Kualifikim i burimeve njerëzore në fushën e menaxhimit të turizmit.
- Masa 6 Promovimi i traditave më të mira të artizanatit vendas dhe zhvillimi i tij në funksion të turizmit.
- Masa 7 Përmirësimi i subvencionimit për aktivitetet start up në fushën e turizmit.
- Masa 8 Planifikim strategjik i zhvillimit të turizmit në Bashkinë Bulqizë.
- Masa 9 Gjallërimi i jetës kulturore, artistike e sportive dhe infrastrukturës përkatëse.

4: Investimi në burime njerëzore të kualifikuara për përballimin e sfidave të konkurrencës globale.

- Masa 1 Investim në ngritje të kapaciteteve të administratës publike për shërbime cilësore ndaj publikut dhe në kuadër të integritetit evropian.
- Masa 2 Nxitja e frekuencimit të arsimit profesional dhe kurseve të kualifikimit.

5: Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe mjedisit nëpërmjet planifikimit të integruar urban dhe rural të territorit, mbrojtjes së pasurive natyrore dhe rritjes së përfitimeve që vijnë nga ato.

- Masa 1 Planifikim i zhvillimit urban e rural në Bashkinë Bulqizë dhe krijimi i Agjencisë së Zhvillimit Vendor dhe Grupeve të Veprimit Lokal (LAG).
- Masa 2 Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit nga dëmtimet dhe prej shfrytëzimit pa kriter të burimeve natyrore.
- Masa 3 Sigurimi i përfitimeve më të mëdha për komunitetin vendor nga dhënia për shfrytëzim e pasurive natyrore, pyjeve, minierave, hidrocentraleve.

6: Kthimi në gjendje normale të infrastrukturës bazë në dobi të një jetese cilësore në Bashkinë e Bulqizës.

- Masa 1 Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë e kanalizimeve.
- Masa 2 Ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, sociale e arsimore.
- Masa 3 Sigurimi i një menaxhimi të qendrueshëm të mbetjeve.
- Rritjen e të ardhurave që bashkia përfiton nga shfrytëzimi i burimeve natyrore si miniera, pyje, energji hidrike dhe të ardhura nga tatim-taksat;
- Shfrytëzimin e qendrueshëm të burimeve natyrore, veçanërisht të pyjeve;
- Nxitjen e zhvillimit të bujqësisë e blegtorisë dhe zinxhirit të vlerës së tyre në funksion të punësimit dhe zhvillimit të turizmit;
- Përmirësimin e infrastrukturës bazë të Bashkisë Bulqizë në funksion të rritjes së cilësisë së jetesës;
- Fuqizimin ekonomik e social të shtresave vulnerabël, veçanërisht të grave nëpërmjet krijimit të shanseve të barabarta në punësim, arsim, shërbime e vendimmarje;
- Përpjekje më të mëdha në përmirësimin e burimeve njerëzore të Bashkisë Bulqizë dhe qëverisjes së mirë, në kuadër edhe të integritetit në BE;
- Nevojën për planifikim të integruar të zhvillimit në Bashkinë Bulqizë;
- Nevojën për investime në kulturë, art dhe aktivitete rekreative;

3.2.1 Paraqitja e projekteve kryesore-arsyet dhe përfituesit

Ne zbatim të ligjit nr. 139 "Per Veteqeverisjen Vendore", neni 41, pika ç, duke u bazuar ne nevojat per investime, Drejtoria e Planifikimit të Territorit ne bashkepunim me Drejtorine e Zhvillimit Ekonomik i propozojne Keshillit Bashkiak:

Te miratoje listen e investimeve per vitin 2026-2028, qe vijon si me poshte:

Projektet e investimeve.

Paraqitja e projekteve kryesore-arsyet dhe përfituesit

Ne zbatim të ligjit nr. 139 "Per Veteqeverisjen Vendore", neni 41, pika ç, duke u bazuar ne nevojat per investime:

1. Sistemim - Asfaltim i Segmentit të Rrugës Çerenec - Viçisht, Nj. Adm. Gjoricë" .

Vlera e Investimit: 89,905,140 (tetedhjetë e nentemilion e nenteqinde e pesemije e njeqinde e dyzete leke me T.V.SH.

Financimi i ketij objekti eshte planifikuar te kryhet ne vleren 38,100,000 (tridhjetë e tetë milion e njëqindë mijë) ne vitin 2025, 51,705,140 (pesëdhjetë e një milion e shtateqindë e pese mijë) e njeqinde e dyzete leke ne vitin 2026

Nr. i përfituesve direkt dhe indirekt: rreth 1600 banore.

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim asfaltim i rrugës Çerenec-Viçisht, Njësia Adm. Gjoricë.
Tipi i projektit	Infrastrukturë

Vendndodhja e projektit	Njësia Administrative Gjoricë
Buxheti total i projektit	89,905,140 me tvsh ALL
Përshkrimi i projektit	Segmenti aktualisht paraqitet në një gjendje jo të mirë, sidomos gjatë periudhës që bien reshje kalimi vështiresohet së tepërmi, pasi rruga me kalimin e viteve është amortizuar goxha dhe në vende të ndryshme krijohen peligje uji të shumta. Rruga është me trase ekzistuese, e cila në disa segmente të caktuara ka nevojë edhe për zgjerim , ku mungojnë shtresat mbushëse dhe asfaltike. Perfituesit direkt janë 1600 banorë. ▪ Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstruksion tërësor, por vetëm mirëmbajtje rutinë. ▪ Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për: - transportin e njerëzve dhe të mallrave aksesin ndaj shërbimeve bazë ▪ punësimin dhe zhvillimin ekonomik ▪ lëvizjen e nxënësve për në shkollë
Qëllimi dhe objektiva	Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektiv ♣ Të përmirësohet infrastruktura e transportit ♣ Të përmirësohet aksesin në shërbimet bazë ♣ Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik
Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: ♣ Ulje të kostove të transportit ♣ Rritja e të ardhurave dhe përmirësim i mirëqenies ekonomike ♣ Rritja mundësive për punësim dhe të aksesit në tregun e punës ♣ Frenim i largimit të popullsisë ♣ Uljen e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve ♣ Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti ishte në rendin prioritar për vitin 2025
Qendrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë.

Aktivitetet e projektit	♣ Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër ♣ Miratimi i lejeve administrative ♣ Zbatimi i projektit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti ka qenë në listën e prioriteteve për investime të Njësisë Administrative Gjorice sipas Planit strategjik të zhvillimit

2. "Sistemim - Asfaltim i Rrugeve te Lagjeve ne Fshatin Valikardhe, Nj. Adm. Zerqan ".

Vlera e Investimit: 19,586,908 (nentembdhjete milion e pesëqindë e tetedhjetë e gjashtë mijë e nentqinde e tete) leke me T.V.SH

Financimi i këtij objekti eshte planifikuar te kryhet ne vleren **7,050,000** (shtatë milion e pesëdhjetë mijë) ne vitin 2025, **9,400,000** (nëntë milion e katërqindë mijë ne vitin 2026, si dhe **3,136,906** (tre milion e njeqinde e tridhjetë e gjashtë mijë) leke ne vitin 2027.

Nr. i përfituesve direkt dhe indirekt: rreth 600 banore

Titulli/Emërtimi i projektit	Sistemim asfaltim i rrugëve të Lagjeve në Fshatin Valikardhë, Njësia Adm. Zerqan.
Tipi i projektit	Infrastrukturë
Vendndodhja e projektit	Njësia Administrative Zerqan
Buxheti total i projektit	19,586,908 me tvsh ALL
Përshkrimi i projektit	Segmenti aktualisht paraqitet në një gjendje jo te mirë, sidomos gjatë periudhës që bien reshje kalimi vështiresohet së tepërmi, pasi rruga me kalimin e viteve është amortizuar goxha dhe në vende të ndryshme krijohen pellgje uji te shumta. Rruga është me trase ekzistuese, e cila në disa segmente të caktuara ka nevojë edhe për zgjerim , ku mungojne shtresat mbushëse dhe asfaltike.Perfituesit direkt jane 600 banorë. ▪ Rruga asnjëherë nuk ka pasur një përmirësim apo rikonstrukcion tërësor, por vetëm mirëmbajtje rutinë.

	- Gjendja e keqe e rrugës është një pengesë serioze për: transportin e njerëzve dhe të mallrave aksesin ndaj shërbimeve bazë - punësimin dhe zhvillimin ekonomik - lëvizjen e nxënësve për në shkollë
Qëllimi dhe objektiva	Qëllim i projektit është përmirësimi i cilësisë së jetësës, me objektiv - Të përmirësohet infrastruktura e transportit - Të përmirësohet aksesit në shërbimet bazë - Të rriten mundësitë për zhvillim social-ekonomik
Rezultatet e pritshme	Ndër rezultatet e pritshme janë: - Uljë të kostove të transportit - Rritja e të ardhurave dhe përmirësim i mirëqenies ekonomike - Rritja mundësive për punësim dhe të aksesit në tregun e punës - Frenim i largimit të popullsisë - Uljën e shpenzimeve për mirëmbajtjen e automjeteve - Gjallërim të jetës sociale
Rendi prioritar	Projekti ishte në rendin prioritar për vitin 2025
Qendrueshmëria e projektit	Pranë bashkisë do të ngrihet njësi për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore lokale. Fondi për administrimin dhe mirëmbajtjen e rrugës do të parashikohet çdo vit në buxhetin e bashkisë.
Aktivitetet e projektit	- Aplikimi tek fondi i Rajoneve apo tek ndonjë donator tjetër - Miratimi i lejeve administrative - Zbatimi i projektit
Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	Ka ndikim në mjedis, por në bazë të masave zbutëse të propozuar në studimin e ndikimit në mjedis do të minimizohet ndikim
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim	Projekti për përmirësimin e këtij segmenti është i hartuar dhe ndodhet në bashki me të gjithë specifikimet teknike, relacionin, preventivin, projektit e zbatimit dhe studimin e ndikimit në mjedis.
Planifikimi vendor, ndërvendor, kombëtar	Projekti ka qenë në listën e prioriteteve për investime të Njësisë Administrative Zërqan sipas Planit strategjik të zhvillimit

